



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje me dyer të mbyllura)

(Mbajtur, më 28.09.2020)

Pika 22 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.2/2020, të filluar në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelin Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:30 dhe mbaroi në orën 12:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

RENDI I DITËS:

22. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.2/2020, të filluar në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelin Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Medi Bici, i cili parashtron shkurtimisht relacionin shpjegues lidhur me projektvendimin “Për caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.2/2020, të filluar në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelin Tiranë”.

Zoti Bici informon se pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për “Shkarkim nga detyra”.

Nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit, i cili do të caktohet nga anëtarët e Komisionit Disiplinor.

Në këto kushte, i kërkohet mbledhjes plenare caktimi me short i relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.02/2020, të filluar në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Futen në enën e qelqit tre emrat e anëtarëve të Komisionit Disiplinor: z. Medi Bici, z. Maksim Qoku dhe z. Dritan Hallunaj.

Pas përzgjedhjes së gogllës, relator për çështjen e sipërcituar është z. Dritan Hallunaj.

Hidhet në votim propozimi i cili miratohet unanimitisht nga të gjithë anëtarët e Këshillit.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor z. Dritan Hallunaj në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor nr.2/2020, në ngarkim të magjistratit {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

2. Ky vendim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit {...}, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

* * *

(Pika 22 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Kryetare
NAUREDA LLAGAMI

Zëvendëskryetar
MAKSIM QOKU

Anëtar
MEDI BICI

Anëtar
ILIR TOSKA

Anëtare
BRIKENA UKPERAJ

Anëtare
FATMIRA LULI

Anëtare
BRUNILDA KADI

Anëtare
MARÇELA SHEHU

Anëtar
ERJON MUHARREMAJ

Anëtar
ALBAN TORO

Anëtar
DRITAN HALLUNAJ

Mbajtur, Specialiste
Rosalba Xhabrahimi